



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nenin 6.1 (a) dhe nenin 15.1 të Rregullës Zgjedhore nr.01/2013, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** me datë 02.03.2018 merrë këtë:

## V E N D I M

### Për pezullim nga regjistri i partive - PARTIA REPUBLIKANE E KOSOVËS- PRK

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për pezullim të Partisë Politike, "Partia Republikane e Kosovës - PRK" për mos mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor në pajtim me neni 15.1 të Rregullës 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.
- II. Në bazë të nenit 6.1 të Rregullës 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, "Partia Republikane e Kosovës - PRK", pas marrjes së vendimit për pezullim ka afat të shtuar prej dyzet e pesë (45) ditë për të mbajtur Kuvendin, në të kundërtën çregjistrohet nga regjistri i partive politike në pajtim me nenin 8 (e) të kësaj Rregulle.
- III. Obligohet Zyra që ta njoftoj përfaqësuesin e Partisë Politike "Partia Republikane e Kosovës - PRK", për marrjen e këtij Vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

"Partia Republikane e Kosovës - PRK", në bazë të autorizimeve ligjore të përcaktuara me nenin 15.1 të Rregullës Zgjedhore nr.01/2013, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike nuk ka mbajtur kuvendin zgjedhor brenda dyzetë e tetë muajve (48), sipas afatit ligjor. Andaj, duke u nisur nga këto që u tha më lartë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bazë të nenit 6.1 të Rregullës Zgjedhore nr.01/2013, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, pezullon nga regjistri i partive politike, partinë "Partia Republikane e Kosovës - PRK" për mos mbajtjen e kuvendit zgjedhor.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, në afat prej 24 orëve nga marrja e këtij vendimi.

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

  
Valdete DAKA

